

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2005/2

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIKUT NR. 2003/41 MBI
MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
AUTORIZIMIN PËR SHPENZIME GJATË PERIUdhËS
PREJ 1 JANAR DERI MË 31 DHJETOR 2004**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/41 të datës 31 dhjetor 2003 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin për shpenzimet për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2004,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/4 të datës 1 shkurt 2005 për vazhdimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin për shpenzime gjatë periudhës prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2004,

Duke vepruar në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me nenin 8.1(c) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh Ligjin mbi menaxhimin e financimit publik dhe përgjegjësitë (LMFPP) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 janar 2003 (Ligji 2003/2), ashtu siç është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17, i cili më vonë është ndryshuar,

Pas konsultimit me Qeverinë dhe këshillimit me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës,

Duke njohur rrethanat e veçanta për shkak të të cilave Kuvendi të Kosovës i nevojitej kohë shtesë për shqyrtimin e propozimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2005 pas zgjedhjeve të përgjithshme në tetor të vitit 2004 dhe formimit të Qeverisë,

Pas vazhdimit të periudhës efektive të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41 për të përfshirë muajin e parë të vitit fiskal 2005 sipas Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2004/31 të datës 27 dhjetor 2004, në pajtim me nenin 21 të LMFPP-së,

Pas vazhdimit të mëtejme të periudhës efektive të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41 për të përfshirë dy muajtë e parë të vitit fiskal 2005 sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/4,

Duke pritur përfundimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2005,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1

Ndarjet e autorizuar buxhetore

Sipas kësaj Urdhërese administrative, të plotësuar me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2004/31, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe ndarjet e autorizuar nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për dy muajtë e parë të vitit fiskal 2005 do të jenë ashtu siç janë paraqitur në pasqyrat 1 dhe 2, që i bashkëngjiten kësaj Urdhërese administrative. Pasqyra 2 përfshin:

(a) Ndarjet për çdo organizatë buxhetore baraz me dy të dymbëdhjetat (16.67%), d.m.th. një të dymbëdhjetën (8.33%) për secilin nga dy muajtë e parë të vitit fiskal 2005, të ndarjeve të siguruara për organizatën e tillë buxhetore sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41 bazuar në pasqyrat e bashkëngjitura Rregullores në kohën e shpalljes së saj;

(b) Ndarjet buxhetore për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për minierat e Trepçës baraz me dy të dymbëdhjetat (16.67%) e ndarjeve të siguruara për këtë sipas Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2004/3 të datës 6 mars 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41;

(c) Ndarja buxhetore për autoritetin rregullativ të telekomunikacionit baraz me dy të dymbëdhjetat (16.67%) e ndarjes të siguar për këtë sipas Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2004/20 të datës 21 korrik 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/41;

(d) Ndarja buxhetore për importimin e energjisë elektrike në shumën që pasqyron kërkesat sezonale për importimin e tillë në janar dhe shkurt;

(e) Fondet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2004 që duhet të përfshihen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës të vitit 2005 për organizatat buxhetore për shkak të kalimit nga ndarjet buxhetore të bazuara në zotime në ato të bazuara në para të gatshme. Fondet e tilla ndahen nga Ministria për Ekonomi dhe Financa në shumat që i nënshtrohen çfarëdo korigjimi duke pasur parasysh çfarëdo shpenzimi të bërë nga zotimet e vitit 2004 që është pritur të zhpenzohen në vitin 2005. Çdo korigjim i tillë pasqyrohet në mënyrë përkatëse në Buxhetin Përfundimtar të Kosovës për vitin 2005;

(f) Ndarjet buxhetore për dy muaj punë të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, të Ministrisë për Energji dhe Miniera dhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal;

(g) Ndarja buxhetore për një muaj punë të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale, të cilit po ashtu i caktohet ndarja sipas Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2004/31 e bërë për Drejtorinë e minierave dhe të mineraleve;

(h) Ndarjet për t'i mbuluar kërkesat për dy muajtë e parë të vitit fiskal 2005 për pensionet themelore dhe pensionet invalidore në shuma që pasqyrojnë parashikimet për vitin fiskal dhe

(i) Ndarjet për Fondin e Kosovës për Rindërtim të cilat janë siguruar, por që nuk janë shpenzuar gjatë vitit 2004.

Neni 2

Harmonizimi me ndarjet buxhetore të vitit të plotë 2005

Në rastet kur fondet ndahen sipas nenit 1 për linjat buxhetore që ekzistonin në vitin 2004 dhe të cilat nuk janë përfshirë në Buxhetin e Kosovës për vitin 2005, fondet e tilla të ndara hiqen nga këto ndarje që i janë siguruar organizatës buxhetore për vitin 2005 që i përfshinte linjat buxhetore në fjalë në vitin 2004.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 1 shkurt 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm